

<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</p>
---	--	--

**AGJ-2010-129**

Në kontestin e

**Agjencia Kosovare e Mirëbesimit**

*Paditësi*

kundër

**Administrata Tatimore e Kosovës**

Prishtinë

I Padituri

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), Richard Winkelhofer, përkitazi me kërkesën e Sabri Halilit, Gjyqtar i Trupit Gjykses të DHPGJS-së, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në gjykimin e padisë SCC-07-0351, më 15 tetor 2010 lëshon këtë

### **AKTVENDIM**

**Kërkesa për përjashtim aprovet si e bazuar.**

**Gjyqtari Sabri Halili duhet të zëvendësohet me një gjyqtar tjetër të Trupit Gjykses i cili është banor i përhershëm i Kosovës, siç përkufizohet në Rregullat mbi themelimin e Trupit Gjykses dhe Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, për Ndarjen e Lëndëve dhe Rregullave Plotësuese Procedurale, të miratuara nga DHPGJS-ja më 1 gusht 2009.**

**Arsyetimi:**

Në lëndën SCC-07-0351 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), duke ju referuar autoritetit të saj sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, të ndryshuar, "për NSH (Ndërmarrje Shoqërore) [REDACTED]" kërkon nga DHPGJS-ja t'ia ndalojë të Paditurit "të bëjë shitjen e NSH-së dhe asetëve të saja" për shkak të detyrimeve tatimore të papaguara të pretenduara.

Grupi kompetent i Trupit Gjykses të DHPGJS-së për gjykimin e lëndës përbëhet nga Antoinette Lepeltier-Durel, si Gjyqtare Kryesuese e grupit, dhe nga Gjyqtarët Esmat Erterzi dhe Sabri Halili (ky i fundit është banor i përhershëm i Kosovës). Në seancën e datës 28 shtator 2010, Gjyqtarja Kryesuese njoftoi se Gjyqtari Sabri Halili sapo e kishte informuar atë se bashkëshortja e tij kishte punuar për NSH-në e përfshirë në lëndë, se ajo ishte njëra nga punëtorët të cilët presin një pjesë nga të ardhurat e shitjes së NSH-së. Ajo raportoi gjithashtu se Gjyqtari Sabri Halili ka qenë i mendimit se kjo rrethanë mund të shkaktojë konflikt interesi. Gjyqtari Sabri Halili pastaj deklaroi se nuk do të dëshironte të ishte anëtar i panelit nëse ekziston edhe dyshimi më i vogël.

Kjo kërkesë për përjashtimin duhet të pranohet si e bazuar.

Neni 4 i Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6, që merret me papajtueshmëritë dhe përjashtimin e gjyqtarëve të DHPGJS-së, thotë:

"4.1 (...)

4.2 Asnjë gjyqtar i Dhomës së Posaçme nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e një çështje në të cilën ai:

(a) Ka marrë pjesë paraprakisht si përfaqësues apo këshilltar;

(b) Ka vepruar për njërën nga palët;

(c) Ka marrë pjesë si anëtar i gjykatës, i tribunalit, i komisionit të hetimeve ose ka vepruar në ndonjë cilësi tjetër të ngjashme;

### III

(d) Ka lidhje familjare a martesore me palën, ose kur pala është një person juridik a subjekt tjetër që mund të jetë palë në procedurë pranë Dhomës së Posaçme, në pajtim me nenin 5 të Rregullores së Dhomës së Posaçme, ka lidhje gjaku apo martesore me një person, që ka interes kontrollues në atë subjekt, i cili është anëtar bordi i një subjekti të tillë ose ka pozitë të lartë drejtuese në një subjekt të tillë; ose

(e) Ka apo fiton interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ndonjë ndërmarrje apo subjekt që kërkon interes pronësie në një subjekt që është palë në procedurë.

Gjyqtari ka për detyrë të parashtojë kërkesë për përjashtim në rast se kushtet e dhëna në paragrafët (a) deri në (e) më lart janë të pranishme.

4.3 Presidiumi i Dhomës së Posaçme në bazë të kompetencave që i janë dhënë me nenin 10 të kësaj Urdhërese administrative mund të përjashtojë cilindo nga gjyqtarët e Dhomës së Posaçme për të marrë pjesë në gjykimin e ndonjë çështje, qoftë me kërkesën e atij gjyqtari ose të cilësdo pale. Kërkesa për përjashtim të ndonjë gjyqtari mund të parashtrohet në çdo kohë të procedurës.

4.4 Kërkesa për përjashtimin e ndonjë gjyqtari do t'i drejtohet gjykatësit kryesues i cili do ta sjell kërkesën para presidiumit. Në rast të përjashtimit të gjyqtarit në pajtim me nenin 4.3, gjyqtari në fjalë zëvendësohet me një gjyqtar tjetër për një çështje të caktuar, i cili për këtë qëllim do të transferohet nga radha e gjyqtarëve shërbyes."

DHPGJS-ja ende nuk ka arritur kompletimin e plotë të gjyqtarëve siç parashihet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4. Presidiumi (shih nenin 3.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6) ende nuk është themeluar. Në pajtim me nenet 10.1 (b) dhe 10.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6, i takon Kryetarit të DHPGJS-së të vendos mbi kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve, nëse nuk është themeluar Presidiumi (shih nenin 74 të Kodit të Procedurës Civile të RSFJ-së, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 et al, lidhur me nenin 70.3 [a] UA të UNMIK-ut 2008/6).

Arsyet e përkufizuara nga Parashtruesi i Kërkesës, gjyqtarit Sabri Halili, nuk i plotësojnë drejtpërdrejtë kriteret e parapara me nenin 4.2 (d) të UA të UNMIK-ut 2008/4, që ka të bëjë me marrëdhëniet e gjyqtarit nga martesa:

Në rastin në fjalë, asnjë subjekt siç parashihet në këtë dispozite, nuk është palë në procedurë. Në veçanti, NSH [REDACTED] është e përfshirë vetëm derisa Paditësi (AKM) vepron 'për' NSH-në (duhet të vendoset se në çfarë mase një veprim i tillë 'për' një NSH nga AKM-ja është në vijë me ligjin procedural dhe material, dhe çfarë janë pasojat). Për më shumë, bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës sipas pohimit të tij nuk ka ndonjë funksion menaxhues e as ndonjë interes të kontrollit ndaj NSH-së, por ka punuar aty si një punonjëse 'e rregullt', përderisa neni 4.2 (d) i UA të UNMIK-ut 2008/4 përqendrohet qartë në personat me ndikim substancial në NSH, dhe nuk ka për synim njerëzit që i takojnë fuqisë punëtore 'të rregullt' me ndikim të tërthortë.

Sipas kësaj, dhe vetëm duke e marrë parasysh dispozitën e lartpërmendur, nuk do të ekzistonte ndonjë arsye valide për përjashtim.

Sidoqoftë, neni 1.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, për ligjin në fuqi në Kosovë thotë se gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe Protokollet e saj (KEDNJ).

Neni 6 (1) KEDNJ thotë:

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme..."

Nuk mund të ketë një gjykim të drejtë para gjykatës, i cili është apo duket i anshëm kundër njërës nga palët. Procedurat prandaj duhet të arrijnë objektivitetin e tyre të përjashtimit të gjyqtarëve nga gjykimi i një lënde që mund të kenë interes (të perceptuar) në rezultatin e çështjes gjyqësore (*Jacobs & White*, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Edicioni i 4<sup>të</sup>, fq. 181, 183). Sipas jurisprudencës së zakonshme në Evropë, duhet të merret parasysh nëse një soditës i paanshëm dhe i informuar, pasi ti ketë marrë parasysh faktet, do të konstatonte se ekziston një mundësi reale se tribunali është i anshëm. Si rezultat, gjyqtari mund të konsiderohet i anshëm nëse do t'i dukej një soditësi mjaft mirë të informuar se ai po favorizon njërën anë padrejtdrisht kundër anës tjetër. Në interes të reputacionit të sistemit të drejtësisë, zbatohen standarde të rrepta: Vetëm mundësia e dukjes së anshmërisë, nga një vlerësim objektiv, mund të mjaftojë për përjashtimin e një gjyqtari.

Nëse një gjyqtar e ngrit shqetësimin e paanshmërisë së tij apo të saj (perceptimit të saj), në parim kjo është një arsye e mjaftueshme për përjashtim.

Përveç rregullave specifike të përshkruara më lart, UA e UNMIK-ut 2008/6 nuk përmban ndonjë dispozitë të përgjithshme që e adreson çështjen e rrethanave (tjera) që mundën në masë të madhe ta pengojnë paanshmërinë e gjyqtarit. Nuk e përmban as Kodi i Procedurës Civile (neni 71) i RSFJ-së, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 et al, të cilin mundet DHPGJS-ja ta marrë parasysh tek (neni 70.3 [a] UA e UNMIK-ut 2008/6).

Siç shihet, neni 6 (1) KEDNJ megjithatë urdhëron që të merren rrethanat e tilla parasysh. Duke e pasur parasysh këtë, propozimi i vet Parashtruesit të Kërkesës për përjashtim për shkak të perceptimit të mundshëm për paanshmëri përfundimisht do të bëhet sipas:

Sipas nenit 10.1 (i) dhe (ii) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, punonjësit e NSH-ve kanë të drejtë në një pjesë të 20% të të ardhurave nga privatizimi ose likuidimi vullnetar i këtyre NSH-ve. E njëjta vlen për likuidimet e bëra sipas Pjesës VII të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 (neni 44.1 [c] i Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 lidhur me

nenin 39 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6; shih gjithashtu edhe nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12).

Prandaj, vendimi në të cilin ai duhej të merrte pjesë do të mund të ndikonte mjaft shumë në vlerën e NSH [REDACTED], dhe si rezultat edhe në të ardhurat nga privatizimi apo likuidimi që do tu ndahen punëtorëve, mes tyre edhe bashkëshortes së Parashtruesit të Kërkesës.

Duke i pasur parasysh këto rrethana, një sositës i paanshëm dhe i informuar do të mund të konstatonte se ka pasur mundësi reale se ai ishte i anshëm. Prandaj, propozimi i vet Parashtruesit të Kërkesës është i bazuar.

Në procedurat e përjashtimit nuk ngarkohen taksa gjyqësore.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar i EULEX-it

nënshkuar